

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E KESHILLIT BASHKIAK

Parimet, përgjegjësitë dhe kompetencat e këshillave bashkiakë



- Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë persona juridikë publikë me vazhdimësi,
- Ato ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore,
- Këshillat bashkiakë janë organi përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore të cilët funksionojnë si organe kolegjiale,
- Këshillat përbëhen nga antarët të cilët zgjidhen me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të lirë dhe të fshehtë
- Numri i këshilltarëve llogaritet përputhje me numrin e popullsisë sipas nenit 46 të ligjit 139/2015,
- Këshilli bashkiak ushtron funksionet e tij nga data e konstituimit, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës.

- Ligji 139/2015 i ka dhënë NJQV-ve të gjitha instrumentat nepermejt të cilave aout mund të ushtrojnë të drejtat dhe kompetencat e tyre,
- Ato e ushtrojnë të drejtën e qeverisjes duke:
 - Përcaktuar masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve,
 - Nxjerr urdhëresa, vendime dhe urdhra bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore,
 - Krijojnë struktura administrative,
 - Krijojnë njësi ekonomike/ose jo-ekonomike dhe institucione në varësi të tyre,

- Ligji 139/2015 i ka dhënë NJQV-ve i ka dhënë bashkive një pjesë të rëndësishme nga të drejtat qeverisëse. Ato përmbledhin një fushë të konsiderueshme të përgjegjësive të cilat përfshijnë:
 - Të drejten e pronës;
 - Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve;
 - Të drejtën dhe përgjegjësinë e kryerjes së veprimtarive ekonomike,
 - Të drejtën e bashkëpunimit,
 - Të drejtën e personit juridik duke gëzuar dhe ushtruar të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të RSH
 - Të drejta të tjera të cilat nuk i janë dhënë me ligj një insitucioni tjetër dhe që lidhen me funksionet bashkiake.

- Kushtetuta e RSH:
- Këshillat Bashkiake marrin vendime për të gjitha çështjet kardinale të veprimtarisë së bashkisë, ato lidhen me:
 - Te drejten e pronës, te drejten ekonomike, te drejten administrative,
 - Vendosjen e taksave, tarifave, të ardhurave në përgjithësi dhe shpenzimet, dmth marrin vendim mbi miratimin dhe ekzekutimin e buxhetit,
 - Përveç sa më sipër Këshilli Bashkiak ushtron të drejta të tjera si:
 - Vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve
 - Cakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e tij në pajtim me ligjin;
 - Krijon simbolet e qeverisjes vendore, si dhe titujt vendor të nderit;
 - Ndërmerr nisma për çështje vendore përpara organeve të caktuara me ligj.

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak, Ligji 139/2015



- Ligji 139/2015:
- Këshillat Bashkiake vendosin për vet-organizimin e këshillit
 - Zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
 - Zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;
 - Emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;
 - Miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të zgjedhur ose të emëruar;
 - Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
 - Zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut,
 - Vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit;
 - Miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak sipas ligjit 68/2017



- Ligji 68/2017 “Për financat vendore”. Ne funksion të këtij ligji KB kryejne:
 - Këshilli bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton:
 - Drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme publike në fushën e financave të njësisë;
 - Prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore;
 - Rishikon politikat fiskale vendore, në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
 - Programin buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
 - Buxhetin vjetor të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
 - Huamarrjen vendore dhe marrjen e masave për sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit financiar të njësisë së vetëqeverisjes vendore.


Struktura e Vetëqeverisjes Vendore (1)



- Struktura e Vetëqeverisjes vendore e nivelit bazë (bashkia) përbëhet nga:
 - Organi përfaqësues – Këshilli bashkiak, dhe
 - Organi ekzekutiv – Kryetari i bashkisë.
 - Në strukturën orgnizative ekzekutive të bashkisë përfshihen edhe Njesitë Administrative
- Struktura e Vetëqeverisjes vendore e nivelit të dytë (qarku) përbëhet nga:
 - Organi përfaqësues – Këshilli I qarkut, dhe
 - Organi ekzekutiv – Kryetari i këshillit të qarkut
- Përgjegjësitë, funksionet dhe të drejtat e këtyre niveleve varen nga mënra e zgjedhjes dhe se cfarë është përcaktuar specifikisht në ligjin 139/2015 për secilin nivel.
- Strukturat komunitare në qytet dhe në fshat.

Struktura e Vetëqeverisjes Vendore (2)

Në mënyrë skematike strukturat përbërëse të NjQV-se pranë bashkisë të cilat kanë për qëllim kryesor shërbimin ndaj qytetarëve.



- Konstituimi i Këshillit Bashkiak i jep rolin të ushtrorë kompetencat nga cdo këshilltar:
 - Këshilltari nuk mund të jetë;
 - kryetar dhe zëvendëskryetar i bashkisë;
 - sekretar i këshillit bashkiak;
 - nëpunës I administratës së bashkisë përkatëse dhe institucioneve në varësi të saj;
 - deputet;
 - Ministrit.
- Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një këshill bashkiak dhe nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehrra me nusen e dhëndrin.

- Këshilli konstituohet pas vërtetimit të mandateve të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij,
- Këshilli zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga data e shpalljes së rezultatit nga Komisioni Qendror Zgjedhor. Mbledhja e parë e këshillit thirret nga sekretari i këshillit bashkiak,
- Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij,
- Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë në këtë mbledhje dhe ka për qëllim:
 1. zgjidhet komisioni i mandateve
 2. miratohen mandatet e anëtarëve të këshillit;
 3. këshilltarët bëjnë betimin;
 4. zgjidhen kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit;
 5. zgjidhen anëtarët që do të përfaqësojnë këshillin bashkiak në këshillin e qarkut

- Këshilltari kryen funksionin me shpërblim mujor të barabartë me 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të bashkisë përkatëse.
- Punëdhënësi detyrohet të lejojë anëtarin e këshillit bashkiak të shkëputet nga puna për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak, komisioneve të tij apo aktivitete të organizuara prej këshillit bashkiak.
- Me kërkesën e tij, këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë, nga kryetari i bashkisë përkatëse, çdo dokumentacion i lidhur me bashkinë.
- Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional, sipas programit të miratuar nga këshilli. Financimi për këto raste bëhet sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

- Funksionimi dhe vendim-marrja në këshill, përveç përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, i nënshtrohet rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga vetë këshilli në **rregulloren e brendshme të funksionimit të tij**,
- Ligji 139/2015 përcakton si të detyrueshëm krijim e dy komisioneve brenda këshillit, përkatësisht komisionin e financave dhe të mandateve,
- Ndërsa këshilli është i lirë të krijojë dhe të shuajë komisione të cilat trajtojnë apekte të veçantë të lidhura me funksionimin e këshillit dhe bashkisë në përgjithësi nëpërmjet rregullores së brëndëshme,
- Pavarësisht përcaktimit të vetë këshillit ai mblidhet në çdo rast:
 - me kërkesën e kryetarit të bashkisë;
 - me kërkesën me shkrim të jo më pak se 1/3 së anëtarëve të tij;
 - me kërkesën e motivuar të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

- Mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj.
- Cdo mbledhje pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Mënyra e mbajtjes së procesverbalit dhe e vërtetimit të tij përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.
- Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë.
 - Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur.
- Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
 - Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

- Kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit bashkiak zgjidhen nga radhët e anëtarëve të këshillit. Propozimi për shkarkimin e tyre bëhet me shkrim nga të paktën një e treta e anëtarëve të këshillit.
 - Kryetari i këshillit (ose zëvendëskryetari) kryen këto detyra:
 - Thërret mbledhjen e këshillit, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji;
 - Drejton mbledhjet e këshillit, në përputhje me rregulloren e tij;
 - Nënshkruan aktet që nxjerr këshilli;
 - Kryen detyra të tjera, të përcaktuara në rregulloren e këshillit
- Sekretari i këshillit emërohet dhe shkarkohet nga këshilli bashkiak, në bazë të propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit.

- Këshilli bashkiak ka kompetencën të vendosë për taksat e tarifat vendore sipas parimeve dhe rregullave të disiplinës fiskale dhe financimit të funksioneve të përcaktuara në ligj,
- Këshilli bashkiak merr vendime për:
 - nënkategorizime të bazës së taksës vendore, në përputhje me kushtet dhe interesat vendore, brenda kategorive minimale të përcaktuara me ligj;
 - këshilli bashkiak vendos nivelin e taksës në kufijtë $\pm 30\%$ të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse kur kerkohet për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës;
 - Kur e gjykon të domosdoshme, vendos taksa me karakter të përkohshëm, në interes të përgjithshëm të komunitetit,
 - Merr vendim për numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet të tjera lehtësuese;
 - Vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për grupet në nevojë.
 - Vendos për mënyrën e administrimit të taksave dhe tarifave.
- Këshilli bashkiak ushtron të njëjtat kompetenca për tarifat vendore, si dhe
- Masën dhe mënyrat e zbatimit të sanksioneve për kundërvajtje administrative.